

FJALA E DEPUTETIT ALBAN XHELILI

E ENJTE 8 SHTATOR 2022

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Me keqardhje kam konstatuar se një pjesë e madhe e diskutimeve sot nuk kanë pasur fare lidhje me aktin normativ, në një kohë që po të shikoni rendin e ditës, ka një pikë që është për çështje jashtë rendit të ditës. Aty keni hapësirën e duhur për të diskutuar problematika nga më të ndryshmet, dhe të qani hallet e qytetarëve, meqë ne nuk dimë t'i qajmë. Akti normativ nr. 12, i datës 29.07.2022 ka kaluar në komisionin tonë si komision përgjegjës dhe të them të drejtën aty nuk kemi pasur ndonjë kundërshti thelbësore. Për vetë përmbajtjen e aktit dhe kujdesin që është treguar nga qeveria për të vijuar me mbështetjen për mbulimin e efekteve të krizës globale, që tashmë ka prekur pothuajse të gjithë globin, pa anashkaluar Shqipërinë, nuk kishte sesi të ndodhte ndryshe, pra, nuk mund të kishte kundërshti.

Ministria e Financave e ka përgatitur këtë akt në kushtet e nevojës dhe të urgjencës mbështetur në nenin 101 të Kushtetutës, duke parë edhe një situatë fiskale optimale, që edhe kolegët e përmendën, e cila na sjell një rezultat pozitiv në rritjen e të ardhurave, kjo edhe si rezultat i performancës së administratës tatimore dhe doganore. Këtu dua të them se shpeshherë ose gjithmonë, sa herë kemi efekte pozitive, thuhet që nuk janë falë performancës, por janë falë situatës, ndërsa kur ka efekte negative, thuhet se janë vetëm për faj të performancës sonë. Tani, ose njëra, ose tjetra, të dyja nuk shkojnë. Këto efekte kanë dhënë një rezultat me një rritje të të ardhurave prej 30 miliardësh, krahasuar me aktin normativ nr. 3 ose 40 miliardë krahasuar ligjin fillestar të buxhetit të shtetit.

Gjithsesi, një gjë që nuk duhet lënë pa përmendur, është se ky akt nuk mund të interpretohet si veprimi i vetëm, që u ka ardhur në mbështetje shqiptarëve në këto kohë të vështira, pasi këtu përmenden shpesh të gjitha masat e marra në mbështetje të të gjithë qytetarëve shqiptarë, të

cilat janë të shumta. Një nga elementet kryesore ka qenë ruajtja e çmimit të energjisë për të gjithë qytetarët, ndërkohë që në një kanal televiziv të huaj, pashë që një qytetar i një vendi të Bashkimit Europian paguante 3 deri 4 – fishin e faturës. Unë po ju marr një krahasim me një qytetar që do të harxhojë më pak se 800 kWh, i cili deri dje paguante 10 mijë lekë të rinj, dhe në bazë të standardit të Bashkimit Europian sot do t'i duhet të paguajë 40 mijë lekë të rinj. A do të kishte mundësi t'i paguante?

Të gjithë e kuptojmë, që në këtë rast nuk do të flitej më për krizë, por do të flitej për çështje ekzistence. Por falë masave të marra, ky nivel çmimi është ruajtur dhe ajo familje që ka pasur këtë standard pagese do të ruaj të njëjtin standard. Nuk duhet të bëhemi më katolikë se Papa dhe të themi: “Shikoni shtresat në nevojë, duhet t'i mbrojmë, duhet t'i ruajmë, por duhet të ruajmë edhe atë që harxhon 3 mijë kWh”. Po, mund të jem edhe unë ndonjë nga ata që harxhoj aq, por kjo do të jetë një shtysë, që do të më bëjë të kursej pak dhe fëmijës tim t'i them fiki drita që i lë të gjitha ndezur. Gjithashtu, një nga masat ka qenë (që për fat të mirë ndoshta e kemi harruar tani situatën e Covidit) edhe rimbursimi i të gjitha recetave të medikamenteve për trajtimin e këtij virusi. Transporti publik vazhdon dhe vijon ta ketë mbështetjen që ka pasur në subvencionimin e çmimi të naftës.

Gjithashtu, edhe për sektorin e bujqësisë, për fermerët, është lënë vlera 500 milionë lekë për subvencionimin e naftës. Është bërë dhe një ndërhyrje e fundit nga qeveria për 500 milionë të tjerë për të stimuluar mbjelljen e kulturës së grurit, ku edhe unë në disa takime që kam pasur edhe me ministren Bujqësisë e kam kërkuar subvencionimin për pjesën e grurit. Kolegët përmendën edhe masat e tjera, si rritjen e pensioneve, ku edhe kolegja Denaj tha një element shumë karizmatik, që kjo ndihmë do të vazhdojë për gjithnjë, nuk po jepet vetëm për një herë. Gjithashtu, 1,67 miliardë lekë ka qenë edhe ndihma ose subvencion, që u është bërë materialeve të ndërtimit, kuptohet për kontratat e punës publike. Paketa e rezistencës vazhdon të ketë pjesën e fondit prej 6,1 miliardësh, që është ajo pjesë, të cilën e përmenda pak më sipër.

Një nga kolegët e opozitës, faktikisht, ishte kolegu që e preku më shumë aktin normativ, përmendi edhe uljen e borxhit, edhe të deficitit. Problematika më e madhe që kemi pasur edhe

ne në komision me kolegët e opozitës ka qenë gjithmonë lufta për borxhin publik. Edhe disa qytetarë, që nuk e kanë shumë të qartë konceptin e borxhit publik, ngaqë janë bombarduar me këto teori, sa të takojnë në rrugë të thonë: “Po ky borxhi publik, përse nuk ulet”? Kështu që, është bërë edhe një ulje në borxhin publik dhe ky është një faktor shumë i rëndësishëm. Pavarësisht këtyre masave, të bësh politikë dekonstruktive në një kohë krize të tillë është shumë e thjeshtë. Po kujt i shërben kjo? Unë besoj se shqiptarëve dhe Shqipërisë asnjëherë.

Në situatë krizash ekonomike armiku më i rrezikshëm është frika dhe pasiguria që krijohet në popull, dhe kjo krijohet nga disa njerëz për përfitime politike, të cilët nuk mendojnë gjatë. Kjo nuk nënkupton që qeveria dhe çdo institucion nuk duhet të jenë transparentë me qytetarët, përkundrazi unë mendoj se kanë qenë mjaft transparentë dhe kanë ruajtur një ekuilibër midis transparencës dhe klimës së të bërit biznes. Për sa i përket krahasimit me Kosovën në lidhje me çmimin e energjisë elektrike, do t’ju them se edhe ndërhyrjet që ka bërë qeveria shqiptare kanë qenë ndërhyrje të përgjegjshme dhe unë nuk do të kërkoja asgjë më tepër. Larg qoftë, sikur të kërkoja ndërhyrje të pandërgjegjshme dhe të papërgjegjshme, që nuk do të rregulloheshin dot për shumë e shumë vite.

Edhe sezoni turistik që sapo kaluam e tregoi këtë gjë, ku falë punës dhe angazhimit të qeverisë dhe institucioneve shqiptare arritëm të kemi një sezon turistik të mirë. Gjithashtu, edhe inflacioni, nëse në Shqipëri vlerësohet me 7,5%, në vendet e BE-së ka kapur vlera 2-shifrore, dhe dua të saktësoj se me këtë krahasim që bëj, nuk do të thotë se ne ia kemi kaluar edhe BE-së, sepse do të vazhdonim ende me histori memesh, që jemi më të mirë se Gjermani, por për të thënë se treguesit makroekonomikë nuk maten me vlera absolute, por në varësi të frymës ekonomike globale, vlerësohen si pozitivë apo negativë. Më konkretisht, sot, edhe pse përpjekjet për të ulur normën e inflacionit nuk duhet të ndalojnë, nuk duhet të na zërë gjumi, nuk mund të themi që kjo është situata më e keqe e mundshme.

Që nuk është e mirë, e pranojmë, por edhe që është më e mira e mundshme në këto kushte, kjo është e qartë. Për të gjitha këto sa thashë më sipër, do t’ju kërkoja ta miratojmë këtë akt normativ. Duke ju uruar një sesion të mbarë, ju falënderoj!